



Procesi i Dialogut - Hapat e mëtejshëm të sugjeruar

Ankesa drejtuar CAO-s në lidhje me impaktin e Projektit të Kompanisë Bankers Petroleum Albania Ltd.

Maj 2014

**Lehtësues të Zyrës së Avokatit/Këshilltarit për Ankesat (CAO)
Kate Kopischke, Rasim Gjoka, Merita Bala**

HYRJE

Në vijim të takimit të datës 27 Janar 2014 me përfaqësues të komunitetit rreth imapktit të punimeve të kompanisë Bankers, për grupin e CAO-s, ishte e paqartë nëse të gjithë personat që morën pjesë në takim kishin vullnetin për t'u përfshirë në një proces dialogu me kompaninë, dhe nëse ishin të gatshëm të vendosnin dhe të ndiqnin disa 'qëllime të dialogut' dhe 'rregulla bazë' që do të mundësonin një proces dialogu të suksesshëm.

Gjithashtu nuk ishte e qartë së sa i përfaqësonin pjesëmarrësit e takimit të janarit interesat më të gjera të komuniteteve përkatëse.

Për këtë qëllim, në muajin prill 2014 grupi i CAO-s bëri takime të veçanta me banorë të komunave dhe persona të tjerë për të qartësuar këto çështje. Hapat e mëtejshëm në procesin e dialogut të drejtuar nga CAO, të propozuar në vijim, bazohen në reflektimet e banorëve gjatë këtyre takimeve, si dhe nga vlerësimet e mëparshme të CAO-s, duke filluar që vlerësimi i parë në muajin Maj 2013, dhe në takimet e mëparshme me palët e interesuara që janë zhvilluar që prej muajit tetor 2013 e në vazhdim.

PROPOZIMI: Tryeza të rrumbullakëta me banorët

Duke marrë parasysh reagimet e njerëzve dhe opinionin e përgjithshëm se grupet më të vogla 'problem-zgjidhëse' janë më efektive sesa grupet e mëdha me përfaqësues nga shumë komuna, në identifikimin dhe adresimin e çështjeve specifike, CAO propozon të asistojë fillimin e 'tryezave të banorëve' në secilën nga komunat.

Tryezat, sapo të krijohen, do të shërbejnë si një forum i rregullt, ku komuniteti dhe përfaqësuesit e kompanisë të mësojnë nga njëri-tjetri, të shkëmbejnë informacione dhe ide, dhe të mendojnë për zgjidhje praktike për çështjet e identifikuar në secilën komunë, dhe të bashkëpunojnë për planifikimet zhvilluese për komunitetin. Çdo tryezë duhet të ketë të përcaktuara qëllimet dhe mënyrën e funksionimit (ose 'rregullat bazë') që duhet të ndiqen në organizimin e diskutimeve dhe aktiviteteve.

Një tryezë ideale do të ishte ajo me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të grupeve të ndryshme të interesit: p.sh., që të përfaqësojnë të rinjtë, të moshuarit, gratë, fermerët, ose grupe të tjera, nga secila komunë. Gjithashtu mund të marrin pjesë dhe disa përfaqësues nga këshilli i komunës. Do të ishte e preferueshme që në tryeza të marrin pjesë anëtarë të komunitetit që nuk janë të zgjedhur apo të emëruar në pozicione drejtuese në nivel komune apo rajoni. Në këtë mënyrë, tryezat do të jenë gjithëpërfshirëse dhe do të përfaqësojnë zërin e banorëve nga secila komunë.

Hapi 1 – Identifikimi i pjesëmarrësve të tryezës së rrumbullakët

Në vijim të diskutimeve që grupi i CAO-s ka pasur me grupe të ndryshme në lidhje me përfaqësimin e duhur dhe efektiv të komunitetit, CAO do të bashkëpunojë me komunat për të identifikuar një grup të vogël (jo më shumë se 8-10 persona) të pjesëmarrësve të tryezës së rrumbullakët, të cilët do të përfaqësojnë zëra apo grupe të ndryshme të komunitetit. Pjesëmarrësit duhet të gëzojnë besimin e një grupi të madh të banorëve të komunës dhe të jenë të gatshëm dhe të kenë mundësi për t'u angazhuar për një periudhë të caktuar kohore (që do të përcaktohet nga vetë grupet) për të marrë pjesë në takime të rregullta (p.sh., mujore ose tremujore); të informojnë komunitetin rreth diskutimeve të tryezës dhe aktiviteteve të grupit, të dëgjojnë dhe të kuptojnë këndvështrimin e të tjerëve dhe të marrin parasysh ide dhe zgjidhje që janë në të mirë të të gjithë komunitetit.

Hapi 2 – Rritja e kapaciteteve

Me përzgjedhjen e pjesëmarrësve të tryezës së rrumbullakët, do të ishte e rëndësishme njohja dhe zhvillimi i disa aftësive për një komunikim efektiv, dëgjim aktiv dhe vendimmarrje të bazuar në interesa. Këto koncepte janë baza e proceseve të suksesshme të zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve; ‘alternative’ do të thotë përpiqesh t’i zgjidhësh problemet në një mënyrë ndryshe, më krijuese dhe gjithëpërfshirëse.

Grupi i CAO-s do të organizojë trajnime 1.5 ditore, si me përfaqësuesit e komunave, dhe me stafin e kompanisë të fokusuar në njohjen dhe zhvillimin e këtyre aftësive.

Hapi 3 – Fillimi i organizimit të tryezave

Pas përfundimit dhe vlerësimit të dobishmërisë së workshopeve për rritjen e kapaciteteve, CAO do të vendosë nëse përfaqësuesit e komunitetit dhe të kompanisë janë të përgatitur për të filluar me diskutimet e rëndësishme. Nëse po, tematika e tryezës së parë do të përfshijë:

- A) Përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave të tryezave (d.m.th., çfarë shpresojnë të arrijnë pjesëmarrësit?);
- B) Mënyra e komunikimit dhe e angazhimit (rregullat bazë për t’i ndihmuar palët të fokusohen në diskutime produktive dhe të parandalojnë mosmarrëveshje të mundshme procedurale të panevojshme); dhe
- C) Përcaktimi i një afati kohor të përgjithshëm për arritjen e qëllimeve afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, të vendosur nga pjesëmarrësit e tryezave. (Që tryezat të jenë të suksesshme, pjesëmarrësit duhet të kenë vullnetin për t’u fokusuar si te shqetësimet imediate të komunitetit, po ashtu dhe te mundësitë afatgjata, sfidat dhe vizioni për të ardhmen).

CAO do t’i fokusojë diskutimet fillestare gjithashtu dhe në qëndrueshmërinë e tryezave dhe strategjitë se si mund të vazhdojë procesi, pasi CAO të përfundojë përfshirjen e tij.